



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt. 01.03.2022	
Zyra e pranimet	Nr. i protokollit
308	01-79

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 01.03.2022

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën me nr prot. 04-472, të datës 29.12.2021, në mbledhjen elektronike të mbajtur më 14.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- REFUZOHET** kërkesa me nr. prot. 04-472, e datës 29.12.2021, parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Serdan Kervan, Prof. Ass. Dr. Munevver M. Yildirim, Prof. ass. dr. Esen S. Kovaç, për realizimin e pagesave të pjesëmarrjes (pagesa e taksës, akomodimit, shpenzimeve të transportit dhe mëditjeve) në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare në Republikën e Turqisë.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 14.02.2022, pasi shqyrtoi kërkesën me nr. prot. 04-472, të datës 29.12.2021, parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Serdan Kervan, Prof. Ass. Dr. Munevver M. Yildirim dhe Prof. ass. dr. Esen S. Kovaç, për realizimin e pagesave të pjesëmarrjes në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare në Republikën e Turqisë, konstatoi se miratimi kërkesës nga ana e Këshillit të Fakultetit të Edukimit është bërë pas pjesëmarrjes së të lartcekurve në Konferencë.

Në Rregulloren për Kërkime Shkencore, neni 10.2 ceket se: Pjesëmarrja dhe prezantimi i punimeve shkencore-kërkimore të personelit akademik të Universitetit, në kongrese/konferenca, me miratim të Këshillit të Njesisë Akademike, përkrahet nga buxheti i Universitetit. Bazuar në këtë rregullore, miratimi kërkesës nga ana e Këshillit të Fakultetit është dashur të bëhej para pjesëmarrjes së të lartcekurve në Konferencë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmenti
- Zyrës ligjore;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

